



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*shprehimur të*  
*separohe 1,*  
*[Signature]*

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_\_/2016

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 7895, DATE 27.01.1995  
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozim të një grupi deputetësh,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet , si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Neni 31, paragrafi 2, ndryshohet si më poshtë:  
Fjalët “si dhe për gratë” hiqen.

**Neni 2**

Neni 46, paragrafi 3, ndryshohet si më poshtë:

Masat edukuese janë:

1. Vendosja e të miturit në një institucion edukimi
2. Qortimi

Qortimi jepet nga gjykata kur sjellja e të miturit kundrejt veprës së kryer, si dhe vullneti i tij për të mos kryer asnjë vepër penale tjetër tregojnë që qortimi do të arrijë qëllimin e edukimit.

Masat edukative që mund të caktohen me urdhër të gjykatës janë:

- a) kërkimi i ndjesës ndaj viktimës (të dëmtuarit);

- b) kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose pagesa e gjobës, sipas aftësive, të ardhurave dhe sendeve pasurore të tij ;
- c) përfshirja në punën e organizatave humanitare ose në aktivitetet që kanë lidhje me komunitetin ose mjedisin;
- d) mos-shkuarja në vende të caktuara ose aktivitete argëtimi ose qëndrimi larg personave të caktuar të cilët kanë efekt të dëmshëm ndaj tij ;
- e) nënshtrimi i një trajtimi profesional mjekësor ose trajtimi për varësinë nga droga ose varësi të tjera me pëlqimin paraprak të përfaqësuesit të tij ligjor;
- d) mos largimi për një periudhë të gjatë kohe nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tij ose i saj i zakonshëm, pa aprovimin e veçantë të marrë nga qendra për mirëqenie sociale.

### **Neni 3**

Neni 51 ndryshohet si më poshtë.

Titulli i këtij Neni ndryshohet: “Dënimi për të miturit”:

### **Neni 51**

#### **Dënimet për të miturit**

Interesi me i larte i të miturit është qëllimi parësor i dënimit penal ndaj tyre. Ri-integrimi në shoqëri dhe rehabilitimi i të miturit në konflikt me ligjin kanë epërsi ndaj dënimit me burgim. Të miturit u nënshtrohen ekskluzivisht sanksioneve të parashikuara në këtë Nen.

Dënimet që u caktohen të miturve janë masat edukative, burgimi dhe dënimet plotësuese. Gjykata mund të vendosë dënimin e burgimit të të miturit nëse caktimi i një mase edukative nuk do të ishte e përshtatshme për shkak të ashpërsisë së veprës penale, pasojat përkatëse dhe shkallën e përgjegjësisë.

Afati i burgosjes së të miturit nuk mund të kalojë gjysmën e afatit maksimal të burgimit të parashikuar për veprën penale.

Në rastin kur i mituri ka kryer disa krime dhe gjykata duhet të japë disa dënime apo të bashkojë disa dënime të dhëna me pare, burgimi i të miturit nuk mund të tejkalojë shtatëmbëdhjetë vjet.

Ne rastet kur gjykata mendon të japë dënim me burgim për të miturin deri në gjashtë muaj, duhet të zbatojë dënimet alternative, pavarësisht llojit të veprës penale të kryer nga i mituri.

Një i mitur mund të lirohet me kusht nëse ka vuajtur të paktën një të tretën e dënimit që është caktuar nga gjykata.

### **Neni 4**

Neni 59 ndryshohet si më poshtë:

Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë , vjet, mund të urdhëroj , që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Para dhënies së një vendimi për ekzekutimin e dënimit me burgim në gjysmë-liri , gjykata shqyrton caktimin e pezullimit të ekzekutimit të një burgimi. Gjukata e pezullon dënimin me kusht vetëm nëse pritet që dënimi do të shërbejë si paralajmërim për kundërvajtësin dhe më vonë ky i fundit, në mungesë të ndikimit të ekzekutimit, nuk do të kryejë vepra të tjera penale.

Ekzekutimi i dënimeve me burgim që janë jo më shumë se dy vjet heqje lirie pezullohen nga gjykata dhe i dënuari vihet në provë, sipas nenit 60 të këtij ligji për sa kohë ajo është e mendimit që i dënuari nuk do të kryejë vepra të tjera penale.

Afati i përgjithshëm i provës është 18 muaj deri në 5 vjet. Afati fillon kur vendimi për pezullimin e dënimit merr formë të prerë. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf.

Gjukata e revokon një dënim të pezulluar dhe urdhëron ekzekutimin e dënimit të dhënë nëse, brenda periudhës së provës, personi i dënuar nuk i përmbush detyrimet e caktuar atij në çështjet kur ai mund t'i kishte përmbushur ato. Në rastin e pamundësisë së përmbushjes së detyrimeve, gjykata mund të zëvendësojë këto detyrime me të tjera, ose të lirojë personin e dënuar nga detyrimet

## **Neni 5**

Neni 60 paragrafi 1. numri 12 ndryshohet si më poshtë:

T'i nënshtrohet një trajtimi, programi mjekësor ose rehabilitimi me qëllim që të ndalohet përdorimi i alkoolit ose narkotikëve;

Neni 60, paragrafi 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“...Detyrimi i caktuar në numrin 11 dhe 12 të këtij Neni caktohet vetëm me pëlqimin e të dënuarit”.

Neni 60 shtohet paragrafi 3 si më poshtë:

“Periudha për përmbushjen e një detyrimi të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni përcaktohet nga gjykata brenda periudhës së vlerësuar të provës”.

## **Neni 6**

Neni 60/a shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje :

"Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës, ose nëse i dënuari nuk përmbush ose nuk ka përmbushur detyrimet e caktuara nga gjykata në kohën e duhur të parashikuara në Nenin 60 të këtij Kodi, punonjësi i shërbimit të provës njofton menjëherë gjykatën që ka dhënë vendimin dhe zyrën e prokurorisë".

### **Neni 7**

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

"Gjykata revokon vendimin që pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim:

- a) nëse i dënuari gjata periudhës së provës kryen një vepër tjetër penale me dashje .
- b) sillet vazhdimisht në kundërshtim me detyrimet e caktuara nga gjykata ose i shmanget mbikëqyrjes dhe udhëzimeve të punonjësit të shërbimit të provës.

Gjykata nuk e revokon vendimin që pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim, nëse është e mjaftueshme:

- a). caktimi i detyrimeve të tjera; ose
- a). zgjatja e periudhës së provës.

Për shkelje të vogla të kushteve dhe detyrimeve që i raportohen gjykatës, gjykata mund të nxjerrë udhëzime në lidhje me aktivitetin e shërbimit të provës dhe të kërkojë raporte në çdo kohë.

Në rastin e revokimit të vendimit që pezullon ekzekutimin e dënimit me burgim, të ardhurat që janë përfituar nga i dënuari sipas Nenit 60 të këtij Kodi nuk rimbursohen. Në këtë rast gjykata merr parasysh shumën e të ardhurave të krijuara nga i dënuari në caktimin e masës së dënimit me burgim. Zbatohen rregullat e konvertimit të gjobës me burgim sipas parashikimeve në këtë ligj.

Gjykata vendos për revokimin e vendimit sipas paragrafit 1 ose 2 të këtij Neni me kërkesën e prokurorit.

### **Neni 8**

Pas Nenit62, shtohet Neni 62/a si më poshtë:

#### **Neni 62/a**

#### **Revokimi i ekzekutimit të dënimit me burgim**

Pas skadimit të periudhës së provës, gjykata vendos revokimin e ekzekutimit të dënimit me burgim.

Gjykata mund të revokojë vendimin që revokon ekzekutimin e dënimit me burgim, nëse personi dënohet në lidhje me një vepër penale të kryer me dashje brenda periudhës kohore të vendosur në provë nga fillimi i periudhës së provës deri në momentin e vendimit që revokon

ekzekutimin e burgimit. Revokimi lejohet brenda një viti nga dita e skadimit të periudhës së provës. Neni 62, paragrafi 4, zbatohen përkatësisht.

### **Neni 9**

Neni 64, ndryshohet si më poshtë:

Një person i dënuar me burgim mund të lirohet me kusht, nëse ai nëpërmjet sjelljes dhe veprimeve demonstroi që qëllimi i ri-edukimit të tij, si pasojë e dënimit të vuajtur, është arritur dhe ai ka vuajtur:

- jo më pak se gjysma e dënimit me burgim të vendosur në lidhje me kundërvajtjet penale;
- jo më pak se dy të tretat e dënimit të vendosur në lidhje me krimet e dënueshme me burgim deri në pesë vjet.

Koha e përfituar nga amnistitë ose çdo falje ligjore nuk llogariten në dënimin e vuajtur.

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apoparagrafi i tretë i nenit 100.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.

Gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës dhe të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara në Nenin 60 të Kodit Penal. Nëse i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës ose nëse ai nuk i përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç urdhërohet nga gjykata, kjo e fundit vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e periudhës së mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës ose revokimin e pezullimit dhe ekzekutimin e dënimit.

### **Neni 10**

Neni 65 ndryshohet si më poshtë:

“Një i dënuar që vuan një dënim me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht nga gjykata nëse ai ka vuajtur të paktën tridhjetë e pesë vjet burgim dhe nëse gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe qëllimi i riedukimit të tij është arritur.

### **Neni 11**

Neni 66, germa a) ndryshohet si më poshtë:

- a) dyzet vjet në rastin e krimeve të dënueshme me burgim të përjetshëm dhe njëzet vjet për krimet, të cilat mund të dënohen me më shumë se dhjetë vjet burgim;

Neni 66 germa b) ndryshohet:

b) pesëmbëdhjetë vjet për krimet për të cilat ligji parashikon dënimet deri në dhjetë vjet burgim;

Pas paragrafit 1 të këtij Neni, shtohet paragrafi 2 me këtë përmbajtje :

“Veprat penale të Seksionit I, Nenet 76 – 79c, nuk i nënshtrohen parashkrimit”.

## **Neni 12**

Neni 89/a, paragrafi 2, ndryshohet si më poshtë :

“ Të njëjtat vepra nëse kryhen për arsye fitimi nga një person i cili abuzon me pozitën e tij ndaj një fëmije ose një personi tjetër veçanërisht të pambrojtur, më shumë se një herë ose në bashkëpunim, ose nëse këto vepra i shkaktojnë dëm të rëndë shëndetit të viktimës, dënohen me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet”.

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 si më poshtë:

Kur nga kjo vepër penale, shkaktohet vdekja e viktimës ose kryhet në kuadrin e një grupi të strukturuar kriminal ose organizate kriminale dënohen nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet burgim.

## **Neni 13**

Neni 134 ndryshohet si më poshtë:

### **Vjedhja**

Përvetësimi i pasurisë se luajtshme, që i përket apo është në posedim faktik të një personi tjetër, për vete apo në favor të të tretëve, kryer me dashje dhe në mënyrë të paligjshme, me qëllim për ta mbajtur përherë atë, në dëm të poseduesit, përbën vjedhje.

Për efekt të kësaj dispozite, pasuri do të konsiderohet edhe çdo lloj energjie që ka vlerë ekonomike.

Toka dhe sendet e paluajtshme do të konsiderohen si pasuri e vjedhur sipas kësaj dispozite, nëse regjimi juridik i tyre, në regjistrat publike, është ndryshuar formalisht nga personi përvetësues në dëm të pronarit.

Sendet që përbejnë pjesë të pandare nga toka apo pasuria e paluajtshme, që shpëputen nga e tera, do të konsiderohen të vjedhura kur përmbajnë të gjithë-elementet e paragrafit të parë të këtij neni dhe nëse përmbajnë vlerë ekonomike me vete.

Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

E njëjta vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet.

#### **Neni 14**

Neni 143 ndryshohet si më poshtë:

“Personi që kryen vjedhje nëpërmjet paraqitjes të rremë të fakteve ose duke fshehur fakte e vërteta, me qëllim përfitimin e paligjshëm material për vete ose për një person tjetër, kryen mashtrim. Dhe dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Në se paraqitja e rreme e fakteve ose fshehja e fakteve të vërteta përbën vepër tjetër penale kemi konkurrim veprash penale.

Kur vepra kryhet në bashkëpunim, apo duke nxitur person tjetër ta kryej atë dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Kur nga vepra penale shkaktohet pasoja të rënda të dëmtuarit dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

#### **Neni 15**

Neni 293/b ndryshon si më poshtë:

#### **Neni 293/b**

##### **Marrja e paligjshme e të dhënave kompjuterike**

Dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar i të dhënave kompjuterike dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Në raste të parëndësishme, e njëjta vepër penale dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

Nëse kjo vepër penale kryhet në kuadrin e një grupi të strukturuar kriminal ose organizate kriminale, nuk zbatohet Neni 334 i Kodit Penal.

Kur kjo vepër kryhet në të dhënat kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo të dhënë tjetër kompjuterike, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

#### **Neni 16**

#### **Neni 293/c**

##### **Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike**

Neni 293/c ndryshon si më poshtë :

Krijimi i pengesave serioze dhe të paautorizuara për të cenuar funksionimin e një sistemi kompjuterik, nëpërmjet futjes, dëmtimit, shtrembërimit, ndyshimit, fshirjes apo suprimimit të të dhënave, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Në raste të parëndësishme, e njëjta vepër penale dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

Nëse kjo vepër penale kryhet në kuadrin e një grupi të strukturuar kriminal ose organizate kriminale, nuk zbatohet Neni 334 i Kodit Penal.

Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### **Neni 17**

Neni 313/b ndryshohet si më poshtë:

### **Neni 313/b**

#### **Ndalimi i dhënies dhe i shpalljes së të dhënave në kundërshtim me ligjin**

1. Kushdo që, duke qenë i paautorizuar, jep ose publikon informacion mbi identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur, anonimë ose vulnerabël ose të një personi identiteti i të cilit është në procedurën për përfshirjen në programin e mbrojtës ose personit të përfshirë në programin e mbrojtjes, si dhe që ndërmer veprime të tjera me synim tregimin e të dhënave të identitetit të atij personi, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.
2. Bërja publike, edhe në organe të medias, në kundërshtim me ligjin e të dhënave me karakter të klasifikuar dhe konfidencial, që rrezikojnë jetën, integritetin fizik ose lirinë e personave të mbrojtur, sipas ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, me qëllim zbulimin e këtyre personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
3. Kur nga kryerja e kësaj vepre kanë ardhur pasoja të rënda për shëndetin e tyre dënohet me burgim nga 6 muaj deri në tre vjet.
4. Kur kjo vepër kryhet nga njëri prej personave që kanë përgjegjësinë për të ruajtur karakterin e klasifikuar dhe konfidencial të të dhënave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet dhe, kur nga kryerja e kësaj vepre kanë ardhur pasoja të rënda për shëndetin e tyre, me burgim nga dy deri në pesë vjet.
5. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.



**Neni 18**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

**KRYETARI**

**ILIR META**